



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA HANI I ELEZIT



REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT
Nr. i Prot. 06/2157
Nr. i Faq. 1 Data 02.04. '25

Datë: 28.03.2025

Komuna Hanit i Elezit

Rrg. Nuri Bushi nr.2

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 neni 17, Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 neni 20 pika 1, Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 neni 4 pika 3 dhe neni 5 pika 2, Vendimit të MMPH me nr.571-2/25 të dt.26.02.2025, Vendimit të Kuvendit të Komunës me nr. 16/15 të dt.27.02.2025 si dhe Udhëzimit Administrativ nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna neni 17, Kryetari i Komunës shpallë për diskutim publik Draft Planin Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033;

NJOFTIM

SHPALLJE PUBLIKE DHE PJESEMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Komuna e Hanit të Elezit përmes këtij njoftimi fton dhe njofton trupat konsultative, publikun e gjërë, ekspertët e fushave dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë dhe japin kontributin e tyre në aspektin e vërejtjeve, sugjerimeve, propozimeve dhe plotësimeve të **Draftit të Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit për periudhën kohore 2025-2033.**

Debati publik do të zgjatë 30 ditë- nga data 15.04.2025-15.05.2025 viti.

Shqyrtimi kryesor publik i Draft Planit Zhvillimor të Komunës do të mbahet me dt.15.04.2025 (e martë) me fillim nga ora 10.15 në sallën e Qendrës Kulturore të Rinisë "Imri Curri".

Draft Planin Zhvillimor të Komunës 2025-2033 mund ta gjeni në ëb faqen e Komunës në linkun: https://hanielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/1.-Draft-PZHK-Hani-i-Elezit-2025_2033_110225.pdf

Komentet, vërejtjet, propozimet si dhe sugjerimet e juaja mund ti bëni nga data 15.04.2025 deri me datë 15.05.2025 në email adresën: Nexhmedin.Daci@rks-gov.net; durim.dernjani@rks-gov.net dhe lusnjaniadnan@gmail.com. **Ose mund ti dorëzoni në kopje fizike në zyrën e Urbanizmit.**

Parcelat e tokave të cilave me Draft Planin e ri Zhvillimor të Komunës do t'ju ndërohet destinimi mund ti shiqoni në ëb faqen e komunës në linkun: <https://hanielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/Lista-e-parcelave-te-cilave-ju-ndryshon-destinimi-me-PZHK-n-e-re-2025-2033.pdf>

Ju lutemi për prezencë dhe kontribut.

Hani i Elezit
28.03.2025



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi